



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Gjakovë-Djakovica-Gjakova
Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. 011/01-14976/2021
Datë: 31.05.2021

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2021 pas diskutimit lidhur me pikën e 7 të rendit të ditës: Plotësim Ndryshimi i komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale sipas vendimit 01 nr.20-37472 i datës 21.07.2016, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet përbërja e Komisionit Vlerësues i caktuar sipas vendimit 01 nr. 011/01-29520 i datës 30.07.2019 për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së paluajtshme komunale në parcelën kadastrale me nr. 1637/1 ZK Gjakovë Qytet, sipas vendimit paraprak 01nr.20-37472 i datës 21.07.2016.
2. Komisioni Vlerësues e ka këtë përbërje :
 1. z. Flamur Fetahaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 2. z. Ferdinand Kola, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
 3. z. Muharrem Musa, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
 4. z. Bashkim Gashaj, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
 5. z. Idriz Daci, përfaqësues i sektorit jo qeveritar .
3. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale vetëm për pronën sipas vendimit paraprak 01nr.20-37472 i datës 21.07.2016 .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
5. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtareve të Komisioni .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Anton Shala